



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028**

Qershor 2025

Hyrje

Planifikimi i buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026, bazuar në planifikimet e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028** është **13,254,881 euro**. Në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2026 janë paraparë 4 milionë euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve **6,941,540 euro**, mallra dhe shërbime **1,513,342 euro**, subvencione dhe transfere **400,000.00 euro**, si dhe shpenzime komunale **400,000.00 euro**. Në kuadër të buxhetit të paraparë për vitin 2026, pjesa më e madhe e planifikimit të të hyrave janë nga Granti Qeveritar (gjithsej Granti nga BKK **12,665,153 euro**), Granti Specifik për Arsimin (**3,766,347 euro**), Granti Specifik për Shëndetësinë (**1,626,763 euro**), si dhe të hyrat vetanake (**589,728 euro**).

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të 11 shtatorit 2008, si dhe Nenit 31 të UA (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkoren Buxhetore 2026/01 të Ministrisë së Financave, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, në koordinim me kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, në bashkëpunim edhe me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale, Grupin Punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës, si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, me datë 25.02.2025, kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, ka nënshkruar Vendimin për formimin e Grupit Punues për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore. Grupi Punues për Buxhetin është i përbërë nga dhjetë (10) anëtarë – zyrtarë, drejtorë komunalë nga drejtori të ndryshme:

1. Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (kryesues i Grupit);
2. Arijeta Skeraj – kryesuese e Kuvendit të Komunës;
3. Burim Aliu – ZKF;
4. Fari Kolloni – zyrtar për Informim;
5. Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
6. Kaltrina Krasniqi – zyrtare për Buxhet dhe Financa në DKA;
7. Bean Hadziasan – drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
8. Arben Skenderi – zyrtar i Financave në Shëndetësi;
9. Lindita Kozmaqi Piraj – zyrtare për Barazi Gjinore; dhe
10. Redzep Ibraimi – drejtor për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Procesit të hartimit të Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 i ka paraprirë Qarkorja Buxhetore 2026/01 e Ministrisë së Financave. Në kuadër të dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga data 10.06.2025 deri më datën 13.06.2025, është diskutuar dhe prezantuar Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Në këtë proces, Zyra për Informim ka qenë e angazhuar në përpilimin e procesverbaleve të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Kalendarin e organizmit të dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës (Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/> ; Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/takimet-publike/>) si dhe në mekanizma tjerë alternativë, të tilla si rrjeti social Facebook (<https://www.facebook.com/profile.php?id=100066575766996>). Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, Komuna e Dragashit ka synuar që dokumentet e projeksioneve buxhetore të jenë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente.

Draft KAB-i 2026-2028 i publikuar në uebfaqen e Komunës: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/DRAFT-KAB-2026-2028.docx>).

Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Njoftimet janë publikuar në gjuhët zyrtare. Çdo vonesë eventuale në publikimin e njoftimeve për dëgjimet buxhetore në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit ka qenë për shkak të problemeve me funksionimin e uebfaqes.

Njoftimet e publikuara në uebfaqen e Komunës:

Shqip:

1. Kalandari i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalandari-Scan.pdf>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftimi-ne-uebfaqe-Degjimi-1.pdf>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftimi-ne-uebfaqe-Degjimi-2.pdf>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë):

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftimi-ne-uebfaqe-Degjimi-3-Scan.pdf>

Boshnjakisht:

1. Kalandari i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Kalendar-boshnjakisht-Scan.pdf>

Njoftimet e publikuara në faqen zyrtare në Facebook të Komunës së Dragashit:

Shqip:

1. Kalandari i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/1F5GBtTo6Y/>

Boshnjakisht:

1. Kalandari i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/15ejZbXLzU/>

Grupi Punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin e Komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore etj.

Bazuar në Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues në koordinim me ekzekutivin e Komunës ka planifikuar të mbajë 3 dëgjime buxhetore, nga data 10 qershor deri më 13 qershor 2025. Në të gjitha dëgjimet buxhetore ka marrë pjesë dhe ka prezantuar para qytetarëve kryetari i Komunës, së bashku me drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.

Tabela me të dhënat e përgjithshme

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë	10.06.2025, 1 orë	33 pjesëmarrës	11 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë	11.06.2025, 1 orë	15 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë)	13.06.2025, 1 orë	34 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Publikimi në uebfaqe / platforma elektronike	15 ditë	0 pjesëmarrës	0 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike (të drejtpërdrejta) si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa tabela e detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më **30 qershor 2025** do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Dragashit.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Funksionalizimi i ujësjellësit për fshati Rapçë; 2. Gjatë periudhës së verës të bëhet mirëmbajtja e rrugëve lokale.	Kamber Kamberi – përfaqësues i fshatit Rapçë	Pranohet Pranohet	Projekti i Ujësjellësit pritet të përfundojë deri në muajin shtator të këtij viti. Ekziston tenderi për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve.
2.	1. Ndërtimi i një muri mbrojtës në varrezat e qytetit, të përfshihet edhe rruga nga ana e poshtme e varrezave, e cila më parë ishte në funksion; 2. Rregullimi i ndriçimit; 3. Nga fabrika deri te stacioni i vjetër veterinar, të bëhet një rrugë si ajo në fshatin Brod, ku lumi është	Sehat Ibraimi – përfaqësues nga Dragashi	Pranohet Pranohet Pranohet	Është në projekt dhe janë ndarë mjete për ndërtimin e një muri mbrojtës te këto varreza, Do të hapen dy tenderë për këtë qëllim, me një shumë rreth 100 mijë euro. Instalimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik është ndër prioritetet kryesore të Komunës. Komuna këtë vit është në procedurë të hartimit të Planit të ri Zhvillimor Komunal. Nëse kjo çështje është e lejuar, mund të paraqitet si kërkesë gjatë

	futur në tuba, dhe mbi lumë të bëhet rrugë, që njerëzit të kenë qasje në parcelat e tyre.			debatit publik për PZhK-në dhe do të shqyrtohen mundësitë për ta realizuar një gjë të tillë.
3.	1. Instalimi i ri i rrjetit të ujësjellësit nëpër komplet fshatin e Bellobradit; 2. Hapja e rrugës nga "Sharra" nëpër Fusha dhe hapja e rrugës në lagjen "Baxhaku" deri në "Mbi Zabel"; 3. Ndërtimi i shtegut të ecjes te lumi i fshatit Bellobrad; 4. Mbulimi i stadionit të shkollës (vetëm me çelik, konstruksion metalik, jo me mure); 5. Kubëzime të nevojshme nëpër fshat dhe kanalizime (e kemi një lagje komplet pa kanalizim).	Ylli Qafleshi – përfaqësues i fshatit Bellobrad	Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet	Ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2026 dhe janë paraparë 70 mijë euro për realizimin e tij. Ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2026 dhe janë paraparë 70 mijë euro për realizimin e tij. Për këtë projekt do të parashihen mjete gjatë planifikimit të buxhetit për vitet në vazhdim. Ky projekt është futur në KAB dhe janë paraparë 30 mijë euro për vitin 2026. Për këtë projekt do të parashihen mjete gjatë planifikimit të buxhetit për vitet në vazhdim.
4.	1. Themelimi i drejtorive të posaçme për Turizëm dhe për Bujqësi.	Beqir Beqaj – drejtor i Radio Sharrit	Pranohet	Për themelimin e drejtorive të posaçme nevojitet ndryshimi i Statutit të Komunës, i cili bëhet me 2/3-tën e votave në Asamble Komunale. Kjo mund të bëhet nëse ekziston vullneti i përbashkët i partive politike

	2. Rehabilitimi i rrugës ekzistuese nga “Ura e Beqës” deri në Mejdan.		Adresohet	që janë pjesë e Kuvendit të Komunës. Kjo kërkesë fillimisht do të adresohet në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
5.	1. Projekte për zhvillimin e turizmit në Komunën e Dragashit.	Nesim Qafleshi – përfaqësues biznesi	Pranohet	Pengesë kryesorë në zhvillimin e turizmit në Komunën tonë është pjesa dërrmuese e territorit e shpallur si park nacional dhe një pjesë e mbetur nën menaxhimin e AKP-së. Ne si Komunë i kemi paraqitur kërkesat tona dhe të qytetarëve për ndërhyrje në zonën e Parkut Nacional Sharri, gjatë kohës së hartimit të Planit Hapësinor për këtë park. Besojmë që këto kërkesa do të merren parasysh dhe do të hapen rrugë drejt zhvillimit të biznesit dhe turizmit.
6.	1. Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit për banorët e pjesës së epërme të Dragashit (nga shpiat e naltshme të Pllajnikut deri te varrezat e Libevishtit); 2. Përcaktimi i vendeve të kontenierëve të mbeturinave;	Nazim Dauti – menaxher i “Ekoregjonit” në Dragash	Pranohet Pranohet	Do të shqyrtohen mundësitë që kjo pjesë të përfshihet në projektin e përgjithshëm të Ujësjellësit për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit. Në KAB 2026-2028 janë planifikuar 100 mijë euro për ndërtimin e dy deponive për mbetje të ngurta (një në Orqushë dhe një në Rrenc). Kjo do të ndikojë dukshëm në zgjidhjen e problemit të mbeturinave në Komunën tonë.

	3. Zgerimi i deponisë kryesore të mbeturinave.		Pranohet	Zgjerimi i deponisë kryesore të mbeturinave është një ndër prioritetet e Komunës për vitet në vazhdim.
7.	1. Trasimi i një rruge prej “Kodrës së Likenit” deri te “Vorri i Madh”; 2. Trasimi i rrugës prej Mejdanit të Buzezit që del në Brrut; 3. Ndërtimi i një muri mbrojtës te shkolla e re.	Gazmend Ramadani – asambleist dhe përfaqësues i fshatit Brrut	Pranohet Pranohet Pranohet	Ky projekt është futur në buxhet dhe janë paraparë 52 mijë euro për vitin 2026. Për këtë projekt është duke u punuar. Ura në këtë pjesë të rrugës është bërë qysh në vitin e parë të qeverisjes. Për këtë projekt do të parashihen mjete në vazhdim.
8.	1. Rregullimi i çështjes së ndriçimit publik; 2. Riparimi i pjesës së dëmtuar nga operatorët ekonomikë të rrugës nga ura e fshatit Shajne deri te pjesa ku shërben si rrugë njëkahëshe gjatë sezonit veror;	Bekim Vehapi – përfaqësues i fshatit Shajne	Pranohet Pranohet	Instalimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik është ndër prioritetet kryesore të Komunës. Për këtë qëllim është paraparë që të investohet me mjetet e fituara nga Granti i Performancës.

	3. Riparimi i rrugës së bjeshkës, të dëmtuar nga vërshimet; 4. Zgjidhja e problemit të deponive ilegale të mbeturinave në fshatin Shajnë.		Pranohet Pranohet	Për rehabilitimin e rrugës së bjeshkës, rrugës “Rumenica” dhe kubëzimin e disa rrugëve tjera në fshatin Shajne janë paraparë 55 mijë euro për vitin 2026. Për këtë qëllim Komuna ka intervenuar dy herë në pastrimin e disa deponive ilegale në fshatin Shajne. Besojmë se këtë problem do ta zgjidhim përfundimisht me hapjen e deponive për mbetje të ngurta.
9.	1. Instalimi i ndriçimit publik brenda fshatit; 2. Kubëzimi ose asfaltimi i rrugës Kosavë-Kuk; 3. Riparimi i rrugës së bjeshkës, të dëmtuar nga vërshimet; 4. Ndërtimi i stadiumit në Mejdan ose te Shkolla, me infrastrukturë përcjellëse dhe një kënd të lojërave; 5. Ndërtimi i disa mureve mbrojtëse përgjatë rrjedhës së	Ardit Kalanderi – përfaqësues i fshatit Kosavë	Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet	Ky projekt është futur në KAB dhe janë planifikuar 30 mijë euro për vitin 2026. Për hapjen, trasimin dhe kubëzimin e rrugës Kuk-Kosavë janë planifikuar 78 mijë euro për vitin 2026. Për këtë projekt do të planifikohen mjete në vazhdim. Ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Kosavë është futur në KAB dhe janë planifikuar 37 mijë euro për vitin 2026. Këto punë do të kryhen në kuadër të projektit për kubëzimin e rrugëve në këto

	lumit, sidomos në mahallat Besen dhe Mejzin;			dy lagje, për të cilin janë planifikuar 30 mijë euro për vitin 2026.
	6. Rregulli i një pjese të kanalizimit të dëmtuar nga vërshimet.		Pranohet	Për këtë projekt do të planifikohen mjete në vazhdim.
10.	1. Përfundimi i projektit të kanalizimit në fshatin Brezne;	Zyber Krasniqi – përfaqësues i fshatit Brezne	Pranohet	Për rindërtimin e kanalizimit në fshatin Brezne janë planifikuar 20 mijë euro për vitin 2026 dhe projekti është futur në KAB. Gjithashtu, janë planifikuar edhe 200 mijë euro për projektin “Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne”.
	2. Funksionalizimi i rrugës që çon drejt Pikës së Take OFF-it;		Pranohet	Rrugën që e kemi trasuar vitin e kaluar do ta kemi parasysh që ta funksionalizojmë tërësisht.
	3. Pastrimi nga bora i rrugëve alternative gjatë sezonit të dimrit;		Pranohet	Këto rrugë çdo herë i kemi hapur dhe do ta kemi parasysh edhe pastrimin e rrugëve alternative edhe në të ardhmen. Mund të ketë vonesa eventuale, por gjithmonë bëhet pastrimi i rrugëve alternative nga bora.
	4. Asfaltimi dhe kubëzimi i rrugëve të mbetura.		Pranohet	Të gjitha rrugët e mbetura lokale do të kubëzohen dhe asfaltohen sipas planifikimeve në vazhdim.

11.	1. Trasimi dhe asfaltimi i rrugës nga fshati për në Bjeshkë;	Brendi Berisha – përfaqësues i fshatit Buqe	Pranohet	Këtë projekt, nëse nuk bëhet me mbështetjen e LMT-së së KFOR-it Turk, do ta marrë përsipër në tërësi Komuna.
	2. Ndriçimi i rrugëve të fshatit;		Pranohet	Projekti “Ndriçimi publik në fshatin Buqe” është futur në KAB 2026-2028 dhe janë planifikuar 28 mijë e 500 euro për vitin 2026.
	3. Rehabilitimi i rrugëve të dëmtuara;		Pranohet	Kjo do të bëhet në kuadër të projektit për kubëzimin e disa rrugëve në fshatin Buqe, për të cilin janë planifikuar 63 mijë euro në vitin 2026.
	4. Lidhja me asfalt e rrugës unazore tek Varrezat, me pjesën kryesoret të fshati.		Pranohet	Kjo do të bëhet në kuadër të projektit për kubëzimin e disa rrugëve në fshatin Buqe, për të cilin janë planifikuar 63 mijë euro në vitin 2026.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/komuna-e-dragashit-filloi-degjimet-buxhetore-me-qytetare-per-kab-2026-2028/>

Boshnjakisht:

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/15jqdoJ6Nu/>

Boshnjakisht:

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtor shëndetësorë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Renovimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës qendrore; 2. Blerja e dy gjeneratorëve për nevojat e shkollës; 3. Krijimi i një qendre për zhvillim profesional dhe inovacion brenda shkollës; 4. Investime dhe renovime të paraleleve të ndara fizike të shkollës.	Flurim Çengaj – drejtor i ShFMU “Fetah Sylejmani” në Dragash	Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet	Për këtë projekt do të planifikohen mjete në vazhdim. Kjo blerje mund të bëhet dhe të planifikohet përmes kategorisë buxhetore “Mallra dhe Shërbime”. Krijimin e qendrave të tilla mund ta planifikojmë në bashkëpunim me donatorë dhe organizata joqeveritare të cilat bashkëpunojnë me Komunën tonë. Renovimet në paralelet e ndara në pjesën e Gorës janë paraparë në kuadër të projektit “Renovimi i të gjitha shkollave në regjionin e Gorës”, për të cilin janë planifikuar 32 mijë euro për vitin 2026.
2.	1. Ndërtimi i një fushe sportive apo salle sportive për shkollën qendrore në Llopushnik;	Behar Shala – drejtor i ShFMU “Shaban Shabani” në Llopushnik	Pranohet	Për këtë projekt do të planifikohen mjete në vazhdim.

	2. Funksionalizimi i kabineteve të shkencave natyrore në shkollën qendrore në Llopushnik; 3. Ndërtimi i një këndi të lojërave për fëmijë në paralelen e ndarë fizike në Brezne, dhe një në paralelen e ndarë fizike në Pllavë.		Pranohet Pranohet	Çështja e funksionalizimit të kabineteve shkollore, të cilat kanë mungesë të pajisjeve të ndryshme, do të zgjidhet përmes kategorisë buxhetore “Mallra dhe Shërbime”. Projektet për ndërtimin e këtyre këndeve do të planifikohen në vazhdim.
3.	1. Rregullimi i stadiumit të shkollës, me infrastrukturë përcjellëse; 2. Ndërtimi i një shupe të re në afërsi të objektit të shkollës; 3. Renovim dhe meremetim i ambienteve të brendshme të shkollës.	Behar Guri – drejtor i ShFMU “Ulina” në Kosovë	Pranohet Pranohet Pranohet	Ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Kosovë është futur në KAB dhe janë planifikuar 37 mijë euro për vitin 2026. Demolimi i shupës së vjetër, ndërtimi i shupës së re dhe ndërtimi i një këndi të lojërave në oborrin e shkollës do të parashihen për vitet e ardhshme. Për renovimet e pjesëve të caktuara të shkollës, të cilat kanë mbetur pa renovuar, do të shqyrtohen mundësitë që këto të bëhen përmes kategorisë “Mallra dhe Shërbime” dhe kapaciteteve buxhetore të DKA-së.
4.	1. Renovimi i sallës sportive të shkollës;	Çenan Skenderoski – drejtori ShFMU	Pranohet	Është futur në Listën e Shpenzimeve Kapitale të KAB 2026-2028 projekti “Renovimi i të gjitha shkollave në regjionin e

	2. Rrethoja nga ana veriore dhe renovimi i katit të parë të shkollës.	“Zenuni” në Brod	Pranohet	Gorës”, ku për vitin 2026 janë planifikuar 32 mijë euro. Është futur në Listën e Shpenzimeve Kapitale të KAB 2026-2028 projekti “Renovimi i të gjitha shkollave në regjionin e Gorës”, ku për vitin 2026 janë planifikuar 32 mijë euro.
5.	1. Sanimi i çative në shkollën e Rapçës dhe në Kërstec; 2. Instalimi i sistemit të vëzhgimit me kamera;	Jasin Bajrami – drejtor i ShFMU “9 Maji” në Rapçë	Pranohet Pranohet	Është futur në Listën e Shpenzimeve Kapitale të KAB 2026-2028 projekti “Renovimi i të gjitha shkollave në regjionin e Gorës”, ku për vitin 2026 janë planifikuar 32 mijë euro. Çështja e instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamera do të zgjidhet përmes kategorisë buxhetore “Mallra dhe Shërbime”.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjimi-i-dyte-buxhetor-me-drejto-re-te-shkollave-pedagoge-punetore-arsimore-dhe-punetore-shendetesore/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzano-je-drugo-budzetsko-saslusanje-sa-direktorima-skola-nastavnicima-prosvetnim-i-zdravstvenim-radnicima/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1YoYg3iL6H/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/15RTj34XqT/>

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë)

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Furnizimi me ujë të pijshëm të përfshihet në investimet kapitale; 2. Rregullimi i vendparkingjeve dhe vendpushimeve; 3. Rikonstruksioni i ndriçimit publik; 4. Rehabilitimi i rrugës Baçkë - Zlipotok.	Zikrija Mehmedoviç – banor i fshatit Baçkë	Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet	Do të shqyrtohen mundësitë që ky projekt të përfshihet gjatë planifikimit të buxhetit për vitet e ardhshme. Do të shqyrtohen mundësitë që ky projekt të përfshihet gjatë planifikimit të buxhetit për vitet e ardhshme. Instalimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik është ndër prioritetet kryesore të Komunës. Ky projekt është i realizueshëm. Në qoftë se nuk mund të bëhet për një vit, do të bëhet një projekt trevjeçar.
2.	1. Përfshirja e mediave në buxhetin komunal;	Nesim Hodza – banor i fshatit Restelicë dhe gazetar	Pranohet	Komuna e Dragashit ka kontrata për shërbime me mediat lokale të cilat i përcjellin aktivitetet publike të institucionit. Gjithashtu, mediat lokale janë të përfshira edhe në shërbimet e ndryshme të informimit publik brenda kategorisë

	2. Rregullimi i rrugës dhe vendosja e tubave (Gornji Most-Mulliri).		Pranohet	buxhetore “Mallra dhe “Shërbime”. Kjo është paraparë në kuadër të projektit “Kubëzimi i rrugëve në rrugën Gorni Most – Visok Zavor në fshatin Restelicë”, i cili është përfshirë në KAB 2026-2028 dhe janë planifikuar 120 mijë euro për vitin 2026.
3.	1. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara; 2. Pagesa e banjës për të gjithë anëtarët e organizatës në Dragash; 3. Blerja e pakove për fëmijët me nevoja të veçanta, më 3 dhjetor (Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara); 4. Të renovohet zyra e organizatës në Dragash, ose të bëhet një zyrë e re, ku krijohet qasje më	Shaqir Skeraj – kryetar i Organizatës për Personat me Aftësi të Kufizuara në Dragash	Pranohet Pranohet Pranohet Pranohet	Kuvendi i Komunës së Dragashit ka miratuar Planin katërvjeçar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028, në kuadër të të cilit janë të parapara objektivat që synojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Do të shqyrtohet realizimi i këtyre pagesave dhe ndarja e mjeteve buxhetore për këtë qëllim. Kjo çështje nuk përbën ndonjë ngarkesë të madhe buxhetore, andaj si kërkesë do të merret parasysh qysh nga dhjetori i këtij viti. Për një zyrë të re mund të jetë problem lokacioni, mirëpo do të shihen mundësitë që të renovohet zyra ekzistuese dhe të bashkëngjitet

	e lehtë për personat me aftësi të kufizuara.			infrastruktura përcjellëse për lehtësimin e qasjes për personat me nevoja të veçanta. Pasi që nuk janë në pyetje shuma të mëdha të mjeteve buxhetore, kjo mund të bëhet përmes kategorisë “Mallra dhe Shërbime”.
4.	1. Funksionalizimi i fizioterapisë, për nevojat e personave me aftësi të kufizuara.	Ismajl Ramdani – përgjegjës i Zyrës së HANDIKOS-it në Dragash	Pranohet	Në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028, të miratuar nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2024, Komuna e Dragashit e ka si objektiv përmirësimin e shërbimeve terapeutike dhe mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe një sërë shërbimesh tjera, të cilat do të realizohen gjatë zbatimit të këtij Plani, në bashkëpunim me partnerë dhe donatorë.
5.	1. A është planifikuar fshati Shajne në projektet dyjeçare 2026-2027 dhe a kanë mbetur mjete që ne t'i parashtrojmë kërkesat tonë të reja?	Bekim Vehapi – përfaqësues i fshatit Shajne	Pranohet	Po, për fshatin Shajne ka projekte të planifikuara për vitet në vazhdim, por mund të merren parasysh edhe kërkesa të tjera gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, bazuar në nevojat e banorëve të fshatit Shajne.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-grupe-te-nenperfaqesuara-per-kab-2026-2028/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzana-je-budzetska-rasprava-sa-nedovoljno-zastupljenim-grupama-za-kab-2026-2028/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/16hoHU4rpj/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1924zzhF7W/>

Tabela me numrin e pjesëmarrësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike

Nr.	Dëgjimi buxhetor	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë			Numri i pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike		
		F	M	T	Shqiptar	Goran/Boshnjak	Të tjerë
1.	Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë	2	31	33	27	2/4	0
2.	Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë	3	12	15	12	1/2	0
3.	Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë)	9	25	34	28	2/4	0
	Totali:	14	68	82	67	5/10	0

Tabela me numrin e kërkesave dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal

Nr.	Dëgjimi buxhetor	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Numri i kërkesave të pranuar apo të adresuara	Numri i kërkesave të refuzuara	Pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal
1.	Dëgjimi buxhetor me kryetarë të këshillave të fshatrave, OJQ, biznese dhe fermerë	37	37	0	2
2.	Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë	14	14	0	0
3.	Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, pensionistë, persona me nevoja të veçanta, të rinj dhe komunitete joshumicë)	12	12	0	0
	Totali:	63	63	0	2

Përgatiti:
Grupi Punues